



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë-Albania

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 827/14 Prot.

Tiranë, më 30.12.2015

VENDIM

Nr. 134, datë 30.12.2015

Në mbështetje të neneve 11, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17 dt.11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit të administruar dhe relacionit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, mbi verifikimin e kryer në lidhje me realizimin e procedurave për nxjerrjen e aktit administrativ nr.26033 prot., datë 23.10.2015, "Dhënie e masës disiplinore vërejtje", të Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ndaj nëpunësit ***** ,

VËREJ:

Në datën 19.11.2015, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka marrë dijeni për veprimin administrativ të Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit, në lidhje me dhënien e masës disiplinore "Vërejtje", ndaj nëpunësit ***** , me detyrë "Specialist Hetues", në Drejtorinë e Hetimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Duke qenë se në dokumentacionin e administruar rezultuan të dhëna që krijojnë bindje për cënimin e të drejtave të nëpunësit civil që garantohen nga legjislacioni për shërbimin civil në lidhje me mos respektimin e procedurave për nxjerrjen e aktit administrativ nr. 26033 prot., datë 23.10.2015, "Dhënie e masës disiplinore vërejtje", të Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ndaj nëpunësit ***** , Komisioneri me urdhrin nr. 827/1 prot., datë 24.11.2015, ka filluar procesin e verifikimit të informacionit.

Gjatë hetimit administrativ të kryer pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në lidhje me dokumentacionin që materializon procedurën e dhënies së masës disiplinore, nga komunikimi me personin e kontaktit, si dhe pas administrimit të provave dhe akteve shkresore, ka rezultuar se punonjësi ***** ka filluar marrëdhënien e punës në pozicionin "Specialist Hetues", në Drejtorinë e Hetimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me aktin administrativ

nr. 8959 prot., datë 14.07.2008. Ky punonjës në referim të nenit 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, është deklaruar nëpunës civil me aktin administrativ nr.3304/24 prot., datë 30.10.2014, të Departamentit të Administratës Publike.

Duke u ndodhur në kushtet kur, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për shkak të natyrës të veçantë të punës, ka si specifike, rregullime të ndryshme ligjore, për sa i përket mënyrës së administrimit të burimeve njerëzore që janë pjesë e shërbimit civil, gjatë hetimit administrativ, nga ana e Komisionerit, janë evidentuar dhe analizuar të gjitha dispozitat në ligjet dhe aktet nënligjore, që kanë lidhje me shërbimin civil në fushën e administratës doganore, ndër të cilat,

- Neni 15, i ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.1995, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*;
- Kreu X *“Disiplina në shërbimin civil”*, i ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 115, datë 05.03.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*; dhe,
- Kreu VI *“Procedura disiplinore dhe Komisioni Disiplinor”*, i Vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për personelin e administratës doganore”*.

Nga përmbajtja e këtyre akteve, si dhe duke pasur parasysh faktin se, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është institucion i administratës shtetërore, në varësi të Ministrisë së Financave (neni 7 pika 1, i Kodit Doganor RSH), rezulton se Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, menaxhon burimet njerëzore të këtij institucioni.

Po kështu, në vijim të analizës së akteve ligjore, rezulton gjithashtu se, për nëpunësit doganore, ashtu si dhe për nëpunësit e tjerë civilë, është i detyrueshëm respektimi i gjithë rregullave të hollësishme, të përcaktuara në dispozitat e neneve 57 deri 61 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar; të Vendimit nr. 115 dt. 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*, si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, *“Për elementët proceduralë dhe materialë të ecures disiplinore dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”*, të Departamentit të Administratës Publike.

Nga hetimi administrativ i praktikës shkresore që materializon procedurën disiplinore, i këqyrrur pranë njësisë së burimeve njerëzore, në dosjen personale të punonjësit ***** , rezulton se procedura disiplinore nuk është kryer në mënyrën e kërkuar nga ligji dhe se në dokumentacionin e paraqitur ekziston vetëm vendimi përfundimtar i eprorit, për marrjen e masës disiplinore.

Në këtë përfundim arrihet duke marrë parasysh faktin se në praktikën që shoqëron veprimin administrativ, nuk rezulton të jetë marrë një vendim për fillimin e ecures disiplinore, si dhe nuk është njoftuar subjekti i procedimit disiplinor (për garantimin e të drejtës që ka nëpunësi për tu njohur me *‘të dhe për të paraqitur me shkrim sqarimet e tij; për paraqitjen e provave, për tu dëgjuar; për të paraqitur dëshmitarë; për datën dhe vendin ku do të zhvillohet seanca disiplinore të cilat kanë afate ligjore të përcaktuara*), ashtu si e kërkon pika 11 e Kreut II të Vendimit nr.115 dt. 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*.

Po kështu, konstatohet se nuk ka të dhëna për akte apo vendime të cilat duhet të merren, gjatë seancës së shqyrtimit të shkeljes disiplinore, duke filluar me verifikimin e njoftimit ose jo të nëpunësit dhe verifikimin e shkaqeve nëse ai nuk është paraqitur.

Një aspekt tjetër, që provon se nuk është respektuar procedura, është fakti se nuk administrohet në dosje ndonjë procesverbal që të përmbajë një përmbledhje të gjithçkaje që është trajtuar në seancën dëgjimore, çështjet që janë diskutuar, argumentet për vendimmarrje dhe vendimet që janë marrë në seancë. Gjithashtu, nuk ka të dhëna për prova, dokumente, shkresa të administruara, apo akte që vërtetojnë shkeljet e pretenduara, si dhe hetim të kryer në lidhje me personalitetin e nëpunësit, për të arritur në një përfundim sa më të saktë në lidhje me llojin e masës disiplinore që do të zgjidhet, etj., ashtu si e kërkon pika 14 e aktit nënligjor të sipërpërmendur (*Vendimit nr. 115 dt. 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave*) dhe Kreu I (eprori direkt), pika "B" e Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike "*Për elementët proceduralë dhe materialë të ecurisë disiplinore dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*".

Nisur nga sa më sipër, arrij në përfundimin se, në nxjerrjen e vendimit përfundimtar për dhënien e masës disiplinore "*Vërejtje*" ndaj nëpunësit ***** , nuk është zbatuar procedura për mënyrën e kryerjes dhe përfundimit të një ecurie disiplinore, përcaktuar në nenet 57 – 60 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; në Vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*"; në nenin 15, të ligjit nr. 102/2014, datë 31.7.2014, "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*"; kreu X "*Disiplina në shërbim civil*"; në Vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "*Për personelin e administratës doganore*" dhe Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014, "*Për elementët proceduralë dhe materialë të ecurisë disiplinore dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*", të Departamentit të Administratës Publike, duke mos respektuar në këtë mënyrë, të drejtat e nëpunësit civil.

Shkelja flagrante e ligjit dhe nxjerrja e një akti administrativ në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar prej ligjit , në bazë të nenit 115 pika "a" dhe 116 pika "c" të ligjit nr.8485 datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të RSH*", e bëjnë këtë akt, absolutisht të pavlefshëm dhe si i tillë, në bazë të nenit 117/1, të ligjit të mësipërm, ai nuk mund të prodhojë pasoja ligjore, pavarësisht nga fakti nëse është deklaruar apo jo si i tillë.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenit 14, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, dhe Rregulloren "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me Vendimin nr. 17 datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Organi disiplinor, në këtë rast eprori i drejtpërdrejtë, të revokojë aktin administrativ nr.26033 prot., datë 23.10.2015, "*Dhënie e masës disiplinore vërejtje*", ndaj punonjësit ***** , si akt absolutisht i pavlefshëm.

2. Njësia përgjegjëse, të fshijë shënimet e bëra për masën disiplinore “*Vërejtje*”, ndaj punonjësit ***** , në dosjen e personale dhe regjistrin e personelit.
3. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Njësia e Personelit të Drejtorisë të Përgjithshme të Doganave dhe punonjësi ***** .
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative të sipërshënuara, lihet afat, **15** ditë.
5. Me kalimin e këtij afati, për përfundimin, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K O M I S I O N E R I

Pranvera STRAKOSHA